

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Xheladin Osmani dhe Artan Sejrani, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarit D. B. për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PP.nr.94/13 të datës 10.07.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat E. R., përfaqësuesit të palës së dëmtuar avokat E. G., më datën 16.03.2017, mori dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I. D. B., nga i ati N. dhe e ëma Gj. –e lindur B., i lindur më ... në Prizren, me banim në rrugën, student i vitit të parë të Fakultetit juridik në UPZ, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim prej dt.14.05.2013 gjerë më 13.06.2013, si dhe në arrest shtëpiak prej datës 13.06.2013 gjerë më 13.07.2013.

ËSHTË FAJTOR

Se më datën 14.05.2013 rrethë orës 16,15 minuta në Lagjen Arbana pikërisht përball objekteve të NTSH “O.” pas një mosmarrëveshje dhe përleshje që ka ndodhur ndërmjet të akuzuarit të parë D. B. dhe të dytë K. B. pasiqë sulmohen ndërmjet vedi i akuzuari D. B. shtënë me armë të zjarrtë në drejtim të K. B. të cilin e plagos me dy plumba në të dy këmbët dhe ate plagë hyrëse – tejshkuese në të dy kofshat e këmbëve nga e djathta në të majtë, të shkaktuara nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrt, i cili lëndim kualifikohet si lëndim i rëndë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit sipas raportit të ekspertit mjeko ligjor Dr. F. D. nga Prishtina.

-Këso dore ka kryer veprën penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 4, 7, 17, 41,45,73,83 dhe 178 lidhur me nenin 28 KP, e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 /dy/ viteve**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.05.2013 gjerë më 13.06.2013, si dhe në arrest shtëpiak prej datës 13.06.2013 gjerë më 13.07.2013, 61 dite.

I dëmtuari K. B. për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguajë paushalin gjyqësor në shumën me nga 400 Euro, si dhe shpenzimet për ekspertizë mjeko- ligjore në shumën prej 70 Euro të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotefuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.94/13 të datës 10.07.2013, kundër të akuzuarit D. B., për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 te KP.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit Mehdi Sefa ka deklaruar se ngelë në tërësi pranë fjalës përfundimtare nga shqyrtimi i mëhershëm pasiqë pas dëgjimit të dëshmitarit Gj. B., të dëmtuarit K. B., raportit të ekspertizës mjeko- ligjor Dr. F. D. përkitazi me natyrën e lëndimeve të K. B. si dhe provave tjera materiale në tërësi është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës. Andaj, konsideron se në veprimet e të akuzuarit D. B. formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të vrasjes në tantivë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP, me propozim që trupi gjykues ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar avokat E. G. në tërësi e ka mbështetur fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit duke theksuar se kërkesën pasurore-juridike do ta parashtronte në kontestin civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit D. B. avokat E. R. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar në formën e shkruar dhe se gjate elaborimit me gojë ka cekur se nga provat të cilat janë nxjerrë gjatë shqyrtimit kryesor në mënyrë të pamohueshme është vërtetuar se ditën kritike i akuzuari D. B. bashkë me vëllain e tij S. B. dhe L. M. janë nisur në drejtim

të Lagjës “Arbana”. Gjatë rrugës L. B. me automjetin e tipit të tij “F. B.” disa herë e ka goditur nga pas automjetin të cilin e ka drejtuar L. M. dhe se nga friga që mos pësoi nga goditjet janë ndalur tek pompa e benzinës “O.”. Në ndërkohë ka arritur me automjet edhe K. B. ku është përlesh me të akuzuarin D. B. dhe ku gjatë përleshjes apo më vonë ka krisur arma gjë që me nxjerrjen e provave ky fakt nuk është vërtetuar. I akuzuari D. B. dhe dëshmitari S. B. nuk pranojnë se i akuzuari D. ka pas ose ka shtënë me armë. I akuzuari K. B. ka theksuar se në posedim të armës ka qenë i akuzuari D. i cili edhe ka shtënë në te gjë që ka deklaruar edhe dëshmitari Gj. B. Në një situatë të këtyllë e nëse edhe i akuzuari D. B. i ka shkaktuar plagë K. B. kemi të bëjmë me veprën penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par.3. të KP sepse në përleshje ka qenë pa fajin e vet gjë që e liron nga përgjegjësia penale. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari D. B. ka poseduar armë dhe ka shtënë në të dëmtuarin K. B. Andaj, në mungesë të provave në kuptim të nenit 363 par.1.p.1.3. të KPP, propozon që gjykata ta liroi nga akuza. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje penale, gjatë procedurës së provave në shqyrtimin gjyqësor të datës 28.10.2016 është ndëgjuar i dëmtuari K. B. i cili ka deklaruar se ditën kritike paraprakisht në “Shadërvan” është takuar me këtu të akuzuarin D. B. dhe se kanë biseduar rreth rastit që ka ndodhur në Durrës pasi që të njëjtit kanë qenë me dy shoqet e tij e njëra prej tyre ka qenë e dashura e tij. Ditën kritike ka qenë duke punuar në pompën e tij të benzinës “V. B.” dhe se në një moment ka vërejtur se ka kaluar me një shpejtësi me automjet L. dhe se mbrapa tij në automjet ka qenë edhe L. B. dhe se duke patur parasysh faktin se paraprakisht në “Shadërvan” është takuar me D. B. dhe L. dhe se pas një mosmarrëveshje që kanë patur, kanë shkuar në NTSH “O.” e që këta paraprakisht ishin ndalë aty. Aty e ka vërejtur D. që ia kishte drejtuar revolen në drejtim të L. dhe se si ka dal nga vetura ka vrapuar me ia kap revolen D. prej dorës dhe se i njëjti në atë moment e ka kthyer revolen kah ai dhe ka shtënë dy herë në drejtim të tij.

Në shqyrtimin e datës së njëjtë është ndëgjuar edhe dëshmitari L. M. i cili ka ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar duke shtuar se me të dëmtuarin K. B. nuk ka patur kurrfarë problemi dhe se ai së bashku me S. kanë qenë maturant dhe se kanë qenë në Shqipëri për pushim të maturantëve në maj të vitit 2013. Me datën 08.apo 10. i dëmtuari K. ka kërkuar D. dhe M. dhe se pasi që nuk i është përgjegjur, K. i është kërcënuar me fjalë “kur të vjen në Prizren mirremi vesh me ty sepse nuk po më tregon se ku janë M. dhe D.”. Ditën kritike ngjarjen kritike nuk e ka parë. Në momentin kur ka dalë prej automjetit në oborr të “O.” ka vërejtur vetëm veturën e L., ka ndëgjuar krisma mirëpo, kush ka gjuajtë nuk e din pasi që është larguar nga vendi i ngjarjes.

Dëshmitari S. B. në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 24.11.2016, ka deklaruar se ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 13.12.2013, ku në mes tjerash ka deklaruar se ditën kritike në oborrin e pompës së benzinës “O.” ka vërejtur te K. B. pistoletën në dorë me të cilën edhe e ka godit në fytyrë dhe se nga goditja ka ra në tokë dhe e ka humbur vetëdijen. Nuk e din se kush ka mundur që tia shkaktonte lëndimet trupore K.

Më datën 13.02.2017 gjatë shqyrtimit gjyqësor është ndëgjuar dëshmitari Gj. B. i cili ka ngelë pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e kaluar duke shtuar se ditën kritike në vendin e ngjarjes vetëm D. e ka parë me armë në dorë e askend tjetër dhe se e ka parë edhe momentin kur D. ka shtënë me armë në drejtim të K. dhe se në atë moment largësia mes D. dhe K. ka qenë 2 – 3 metra. Nuk i kujtohet saktësisht por D. ka shtënë 5 apo 6 herë. Pas shtënjes me armë D. ka ikë në drejtim të panjohur.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është lexuar deklarata e ekspertit të balistikës H. K. nga shqyrtimi i datës 14.01.2014 ku ka deklaruar se i dëmtuari – K. B. plagët i ka marrë nga arma e kalibrit 7.62 x 25 mm, e markës „Tokarev“ apo TT dhe se nga skica e vendit të ngjarjes shihet se të shtënat janë bërë të njëpasnjëshme në një distancë prej pikave fikëse dhe ate gëzhoja nr.4, është më së afërmi nga tri pikat e gjakut 1, 2, dhe 3, e që këto janë largë prej gëzhojës nr.4, 4 metra, 3 metra dhe 2 metra. Pra, të shtënat janë bërë kur personi ka shti me armë së pari në një distancë prej 4 metrave dhe pastaj është tërheqë përmbropa dhe ka ardhë deri aty ku janë gjetë gëzhojat me nr. 5, 6 e ato janë, 5-shi në trotuar afër zyreve të objektit „O.“ ndërsa 6-shi në rrugë. Ditën kritike është përdorë vetëm një armë – tri gëzhoja janë zbrazë nga një armë dhe se lëndimet nuk janë marrë nga një pozicion por kur personi ka qenë në lëvizje – ai që ka shti ka qenë në lëvizje.

Poashtu gjatë procedurës së provave është lexuar edhe deklarata e ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. D. e dhënë në procesverbalin e datës së njejtë të lartëcekur ku ka ngelë në tërësi në mendimin e dhënë me shkrim të datës 09.06.2013, ku edhe ka theksuar se S. B. ka dëmtime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit dhe se i njejtë ka patur ndrydhje (mbretje), me gërvishje dhe dërmishje të indeve të buta të regjionit të faqes së djathtë të fytyrës, regjionit të supit të krahut të dorës së djathtë, regjionit të djathtë të barkut, regjionit në nyzimit (kyqit) të bylyzykut të dorës së djathtë dhe regjioneve të të dy gjunjëve të këmbëve gjakëmbledhje nënëlëkurore në kapakët e syve të shkaktuara me mjet të fort mbretës, jo i mbrreht apo i topitur, ose janë shkaktuar me mjet gërvishës që mund të vjen në shprehje çdo mjet gërvishës, thonjët, rrypi i orës, zingjiri i veshjes, nuk përjashtohet mundësia edhe eventualisht që gjatë rrëximit dhe fërkimit në tokë që të krijohen gërvishje të tilla.

Eksperti mjeko-ligjor Dr. F. D. në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.02.2014, e cila deklaratë poashtu në pajtim me palët është lexuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, sa i përket lëndimeve të dëmtuarit K. B. ka ngelë në tërësi pranë mendimit të dhënë me shkrim të datës 09.06.2013, ku ka cekur se i akuzuari K. B. ka fituar lëndime të rënda trupore – kemi të bëjmë me lëndime në të dy kofshat e këmbëve – të dy gjymtyrët me tension të ngritur të shtypjes së gjakut, me puls të shpejtuar dhe është trajtuar si rast urgjent në Klinikën e ortopedisë. Sa i përket plagëve hyrëse dhe dalëse nuk janë të përshkruara në raportet mjekësore të lartëcekura gjithashtu edhe regjioni i kofshëve të këmbëve nuk përshkruhen – se a kemi të bëjmë me rregjionin e 1/3 të mbigjurit, në mes apo afër gjurit. Per arsyet e cekura edhe eksperti gjatë shqyrtimit gjyqësor në një dhomë të veçantë e ka bërë shiqimin dhe matjen e plagëve të akuzuarit – të dëmtuarit K. B. dhe se pas ekzaminimit fizik të njejtë dhe matjes së plagëve ka theksuar se plaga e këmbës së djathtë nga tabani i këpucëve apo patikëve është në gjatësi prej 73 cm, vraja e cila

prezenton vrimën hyrëse nga ana e djathtë, ndërsa në këmbën e majtë nga tabani i këpucëve distanca është 76 cm, e cila prezenton vrazhën e vrimës dalëse të fundit nga kofsha e majtë. Distanca pas matjeve mes këtyre dy vrazhëve është rreth 3 cm, e cila jep të kuptohet që predha ka shkuar nga e djathta në të majtë, nga poshtë – lartë dhe nga pas – para. Në rastin konkret duke marrë parasysh vrazhët e plagëve të lartëcekura i akuzuari – i dëmtuari K. ka qenë në pozitë ku këmba e djathtë ka qenë prapa këmbës së majtë, që i përgjigjet asaj se këmba e djathtë ka qenë pas, këmba e majtë ka qenë përpara, ka mund të jetë në lëvizje apo duke qëndruar në vend – statikë në pozitë vertikale.

Në bazë të ekspertizës së Njësisë për ekspertim të armëve të zjarrit të datës 24.06.2013, e cila ekspertizë në këtë gjykatë është pranuar më datën 04.07.2013, rrjedhë se dëshmitë e dorëzuara D#4, D#5 dhe D#6, janë tri gëzhoja pjesë të fishekëve të kal.7.62 x 25 mm, dhe se këto tri gëzhoja janë shkrepur prej një arme të kalibrit të njejtë 7.62 x 25 mm. Këto tri gëzhoja mund të shkrepën prej pistoletave të kal. të njejtë 7.62 x 25 mm, të llojit „Crvena Zastava“ model 57, „Tula Tokarev model -31“, type -54, kopje e pistoletës „Tula Tokarev“.

I akuzuari D. B. në mbrojtjen e tij në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.02.2017 ka deklaruar se ditën kritike kur ka ndodhë rasti ka qenë në „Shadërvan“ me vëllaun S. dhe shokun L. dhe se pastaj ka kontaktuar me K. për të biseduar rreth një problemi që e kishin patur në Shqipëri, K., vëllau i tij S., L. dhe Gj. rreth disa femrave. Më tej ka shtuar se ditën kritike me automjet janë nisur për të pirë kafe në Qendrën sportive „Jeta e Re“, në Lagjen Arbana tek pompa e benzinës „G. P. „ ka vërejtë tri vetura të parkuara para pompës dhe se jashtë veturës ka vërejtë K. B., L. B., Gj. B. dhe disa persona tjerë familjar të K. dhe se në atë moment Gj. iu ka dal përpara me qëllim që ti ndal, ndërsa shoku i tij L. ka vazhduar me shpejtësi për tu larguar. Duke u larguar L. B. me veturën e tij ka godit përmbropa me automjet. Pas kësaj janë ndalë tek pompa „O.“ ku ka mbrri edhe L. B. me automjet e pas tij edhe K., L. B. dhe Gj. B. me automjet tjetër. L. e ka kap për fyti dhe se në atë moment e kanë sulmuar vëllaun e tij S. dhe ate K. i cili si ka ardhë në vendin e ngjarjes ka dal prej automjetit e ka nxjerr pistoletën dhe ka shkuar në drejtim të vëllaut të tij S. dhe e ka sulmuar ndërsa K. atë nuk e ka sulmuar. K. me vëllaun e vet L. me armë e kanë godit S. në pjesë të ndryshme të trupit. Pasiqë e ka vërejt vëllaun që është ngritur në këmbë, i ndihmon atij dhe ikin që të dy nga vendi i ngjarjes. Se si është plagosur K. këtë nuk e dinë pasiqë duke ikur për afërsisht 40-50 metra pasiqë janë larguar nga vendi i ngjarjes ka dëgjuar tri krisma mirëpo, nuk ka vërejtë se kush ka gjuajtë pasi ka qenë duke u larguar. Ka cekur se as ai a as ndonjëri prej shokëve të tij ditën kritike nuk kanë patur armë.

Në bazë të provave të lartëcekura, pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari D. B. më datën 14.05.2013 rreth orës 16,15 minuta në Lagjen Arbana pikërisht përball objekteve të NTSH „O.“, pas një mosmarrëveshje dhe përleshje që ka ndodhur ndërmjet të akuzuarit të parë dhe të dytë pasiqë sulmohen ndërmjet vedi i akuzuari D. B. shtënë me armë të zjarrt në drejtim të K. B. të cilin e plagos me dy plumba në të dy këmbët dhe ate plagë hyrëse – tejshkuese në të dy kofshat e këmbëve nga e djathta në të majtë, të shkaktuara nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrt, i cili lëndim

kualifikohet si lëndim i rëndë trupor me dëmtim të përkohshëm për shëndetin sipas raportit të ekspertit mjeko ligjor Dr. F. D. nga Prishtina.

Gjendjen e këtyre faktike gjykata e vërtetoi në bazë të deklaratave të dëmtuari K. B., i cili në deklaratën e tij ka deklaruar se derisa ka tentuar me ia marrë armën prej dorës D., në atë moment ai ka gjuajtur në drejtim të tij dy herë dhe e ka plagosur. Kjo deklaratë e tij vërtetohet edhe nga deklarata e dëshmitarit Gj. B. i cili e ka parë me armë në dorë të akuzuarin D. dhe momentin kur ai ka gjuajtur në K. dhe atë dy herë. Deklaratave të tyre gjykata edhe ia fali besimin pasi që përputhen edhe me lëndimet të cilat i ka fituar i dëmtuari K., e që janë vërtetuar në bazë të ekspertizës së ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. D., i cili si në ekspertizën me shkrim të datës së lartëcekur dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor pas ekzaminimit fizik dhe matjes së plagëve ka theksuar se plaga e këmbës së djathtë nga tabani i këpucëve apo patikëve është në gjatësi prej 73 cm, vraja e cila prezenton vrimën hyrëse nga ana e djathtë, ndërsa në këmbën e majtë nga tabani i këpucëve distanca është 76 cm, e cila prezenton vrazën e vrimës dalëse të fundit nga kofsha e majtë. Distanca pas matjeve mes këtyre dy vrazave është rrethë 3 cm, e cila jep të kuptohet që predha ka shkuar nga e djathta në të majtë, nga poshtë – lartë dhe nga pas.

Poashtu këto fakte janë vërtetuar edhe me prova materiale-gëzhoja të gjetura në vendin e ngjarjes e që pas ekspertizës së kryer nga ana e Njësisë për ekspertim të armëve është vërtetuar se këto tri gëzhoja mund të shkrepen prej pistoletave të kal. të njejtë 7.62 x 25 mm, të llojit „Crvena Zastava“ model 57, „Tulla Tokarev model -31“, type -54, kopje e pistoletës „Tulla Tokarev“. Këtë fakt poashtu e ka shpjeguar edhe eksperti i ballistikës H. K. se i dëmtuari – K. B. plagët i ka marrë nga arma e kalibrit 7.62 x 25 mm, e markës „Tokarev“ apo TT.

Andaj, në bazë të provave të lartëcekura gjykata edhe vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit D. B. formohen elementet qenësore të veprës penale të vrasjes në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP, për çka edhe e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv, pasi që ai ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta, se veprimi të cilin e ka ndërmarr do të mund të privon nga jeta personin – ka gjuajtur me armë në drejtim të personit të paarmatosur dhe se ka dashur që ta privoi nga jeta - pasi që dy herë ka gjuajtur me armë në drejtim të të dëmtuarit.

Nga provat e vlerësuara të lartëcekura vërtetohet dashja dhe vendosmëria e të akuzuarit për të kryer veprën penale. Kjo nga fakti se i akuzuari ka sulmuar personin duarthatë, i cili nuk ka patur me çka të sulmoj as me çka të mbrohet. Këtë fakt ai e ka ditur fare mirë, mirëpo përkundër kësaj ndërmerr veprimet e lartëcekura dhe me dashje e kryen veprën penale për të cilën edhe është shpallur fajtor.

Andaj, bazuar në provat e lartëcekura gjykata edhe ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit krijohen elementet qenësore të veprës penale të lartëcekur, për çka edhe gjeti se është penalo-juridikisht pergjegjës dhe e gjykoj me dënim me burg si në dispozitiv.

Pohimet e të akuzuarit se ditën kritike nuk ka patur armë në dorë e as që ka gjuajtur në drejtim të akuzuarit K. dhe se armë në dorë ka patur vet i dëmtuari K., janë të

papranueshme për gjykatën dhe në kundërshtim me provat e lartëcekura dhe se një mbrojtje e këtitllë e të akuzuarit për gjykatën është vetëm tentim i shmangjes nga përgjegjësia penale. Kjo nga fakti se është e palogjikshme dhe e pakuptimtë pasi që në rastin konkret lëndime nga arma e zjarrit ka fituar i dëmtuari K. e jo i akuzuari D. Andaj, bazuar në të lartëcekurat gjykata edhe ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale të lartëcekur, pasi që i akuzuari ditën kritike me dashje, me armën e kalibrit 7.62 x 25 mm, e markës „Tokarev“ apo TT, e plagos të dëmtuarin K. në të dy këmbët. Se ekziston dashja e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale vërtetohet edhe me vet faktin se i njëjti ka qenë paraprakisht i armatosur dhe ashtu ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe se ka gjuajtur në të dëmtuarin i cili në atë moment ka qenë i paarmatosur, duarthatë, asgjë nuk ka patur në dorë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese gjykata morri parasysh qëndrimin korrekt të tij, se është hera e parë që te akuzuarit bien ndesh me ligjin, moshën e tyre relativisht të re, ndërsa për te akuzuarin L. B. edhe pranimin e fajesisë. Ndërsa prej rrethanave rënduese sa i përket te akuzuarit D. B. peshën dhe natyrën e veprës penale-kemi të bëjmë me veprën penale të drejtuar kundër jetës së njerëzve-vlera të shoqërisë të cilat janë të mbrojtura me ligj, mënyrën e kryerjes-i akuzuari ka sulmuar te dëmtuarin e pambrojtur-i cili ka qenë duarthatë pa kurrfarë mjeti apo arme në dorë. Andaj, është mendimi i gjykatës që dënimet e shqiptuara do ta arrijnë qëllimin e vet konformë nenit 41 të KPK, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarve ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Gjukata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për siguri personale të popullatës së kësaj treve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP në të gjitha segmentet e tij. Dënimet e shqiptuara për kah lloji dhe lartësia janë në harmoni me rrethanat e rastit, të nevojshme dhe të mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartëcekur. Dënimi i shqiptuar të akuzuarve sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të mirret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, dënimet e këtilla paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro-juridike është marrë konform nenit 463 par.2 te KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
Më dt. 16.03.2016 P.nr.18/16

Proçesmbajtësja
Sheqere Braha

Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.